



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E VITISË
 OPŠTINA VITINA, MUNICIPAL VITI
 DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Neni 14, par.2. të Ligjit për Shëndetësi Nr.04/L125, neni 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik , dhe Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Viti, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK

Institucioni:	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Viti
Titulli i vendit të punës:	1 (një) pozitë Infermier/e të përgjithshme – për QMF Pozharan
Titulli i vendit të punës:	2 (dy) pozita Vozitës për QKMF
Kategoria dhe grada e vendit të punës:	- Koeficienti – H – 68 dhe H-71
Orari:	40 orë në javë
Kohëzgjatja e emërimit:	Sipas Ligjit të punës nr. 03/L-212

Detyrat dhe përgjegjësitë për vendin e punës Infermier-e të përgjithshme:

Pranon, triazhon dhe informon pacientin, hap kartelën shëndetësore dhe merrë anamnezën orientuese, aplikon terapinë parenterale, i.m,i.v, subkutan, aplikon infuzionet , bënë inhalimin , përpunimin e plagës, përcjellë kalendarin e imunizimit, aplikon dhënien e oksigjenit, përgjigjet thirrjeve të urgjencave në teren etj. Kryen edhe punë të tjera sipas sistematizimit të vendit të punës. Për punën e vet i përgjigjet shefit të shërbimit dhe infermieres përgjegjëse.

Detyrat dhe përgjegjësitë për vendet e punës Vozitës:

Drejton automjetin apo autoambulancën e QKMF sipas urdhrit të mbikëqyrësit të autoparkut, si dhe kujdeset për automjetin me të cilin është i ngarkuar; Kujdeset për mirëmbajtjen e tij, Mirëmban edhe automjetet e tjera sipas orarit të punës përmes mbikëqyrësit të autoparkut; Në fletudhëtimin regjistron numrin e kilometrave të kaluara në udhëtim, Paraqet mbikëqyrësit të autoparkut çdo defekt dhe dëm të shkakutur në automjet, dhe bën arsyetimin e shpenzimeve të derivateve dhe kilometrazhit të kaluar; Kryen edhe punë tjera sipas urdhrit të mbikëqyrësit dhe drejtorit : Për punën e vet i përgjigjet mbikëqyrësit të autoparkut dhe drejtorit të QKMF-së.

Për vendin e punës **Infermier-e të përgjithshme** kërkohet:

- Shkollën e mesme të mjekësisë - Drejtimi i përgjithshëm

Përvoja e punës:

- Minimum të ketë të mbaruar stazhin e obliguar profesional.

Dokumentet e kërkuara për Infermier kerkohet:

- Kopjet e diplomës së shkollimit të kryer
- Kopjen e licencës së punës valide
- Kopjen e letërnjoftimit
- Çertifikatën shëndetësore,(me rastin e perzgjedhjes së kandidatit-es)
- Ekstrakti i lindjes,
- Çertifikatën që ndaj tij/saj nuk zbatohen hetimet,
- Dëshmi mbi njohjen bazike të punës me kompjuter; - e dëshirueshme

Për vendet e punës Vozitës kërkohet:

- Të ketë të kryer Shkollën e mesme .

Përvoja e punës:

- Dëshmi e përvojës së punës si vozitës,

Dokumentet e kërkuara për Vozitës kërkohet:

- Kopjet e diplomës së shkollimit të kryer
- Kopje e Patent Shoferit të vlefshëm sipas Ligjit në Republikën e Kosovës kategoria "B".
- Kopjen e letërnjoftimit .
- Çertifikatën shëndetësore, (me rastin e perzgjedhjes së kandidatit-es).
- Ekstrakti i lindjes,
- Çertifikatën që ndaj tij/saj nuk zbatohen hetimet,

Komuna e Vitisë, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Aplikacionet e pakompletuara sipas konkursit si dhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

Detyrat e punës për profilet e kërkuara me konkurs janë parashikuar me Ligjin e Shëndetësisë , Statutin e QKMF-së dhe Qarkoren Informative 02/2017 nga Ministria e Shëndetësisë.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren fizikisht dhe mund të shkarkohen në webfaqe të komunës së Vitisë si dhe dorëzohen në Zyrën e Arkivës të Komunës së Vitisë nr.1.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë pas shpalljes.



Drejtori i DSHMS-së

Hanife Januzi
Hanife Januzi